



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:183747

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05844809

KPPP.nr.1906/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përbarimore të kreditorit A.D. B.I. me emër tregtarë N.P.T. “Frutat” me numër unik identifikues 810755126 me seli në Pejë rr. “Nexhip Basha” p.n., me pronare A.D., kundër debitorit “Elnart Group” SH.P.K. me numër unik identifikues 810016320 me seli në Pejë, rr. “Beteja e Loxhës”, përfaqësuar nga Cyma Rexhboqaj, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.203/23 të datës 22.07.2022 të Përbaruesit Privat Zija Bala, me seli në Pejë, jashtë seancës me datës 21.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT si i bazuar prapësimi i debitorit “Elnart Group” SH.P.K., i ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr.203/23 të datës 22.07.2022 i lejuar nga Përbaruesi Privat Zija Bala.
- II. SHFUQIZOHET Urdhri Përbarimor P.nr.203/23 i datës 22.07.2022 i lejuar nga Përbaruesi Privat Zija Bala, lidhur me faturën nr.19SHV01-001-127 të datës 25.11.2019 në shumë prej 5,400.00€, për shkak të përmbushjes dhe PËRFUNDOHET procedura përbarimore sa i përket kësaj fature.
- III. MBETET NË FUQI Urdhri Përbarimor P.nr.203/23 i datës 22.07.2022 i lejuar nga Përbaruesi Privat Zija Bala, sa i përket Faturës nr.241/20 e datës 31.07.2020 në shumë prej 357.50€, Faturës nr.242/20, e datës 19.08.2020 në shumë prej 317.20€, Faturës nr. 243/20, e datës 19.08.2020 në shumë prej 364.00€, Faturës nr.022021001-1, e datës 20.02.2021 në shumë prej 1,600.00€, Faturës nr.013121002-1, e datës 31.01.2021 në shumë prej 1,200.00€, Faturës nr.121421001-1, e datës 14.12.2021 në shumë prej

488.25€, Faturës nr.122221003-1, e datës 22.12.2021 në shumë prej 489.75€, Faturës nr.122921001-1, e datës 29.12.2021 në shumë prej 486.75€, në shumë të përgjithshme prej 4,872.45€.

- IV. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar ankesa e evitimit e parregullsisve debitorit “Elnart Group” SH.P.K., e ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarrimor P.nr.203/23 të datës 22.07.2022 i lejuar nga Përmbarruesi Privat Zija Bala.

A r s y e t i m

Përmbarruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit A.D. B.I. me emër tregtarë N.P.T. “Frutat” ka lëshuar Urdhrin Përmbarrimor P.nr.203/23 të datës 22.07.2022 me të cilin e ka lejuar përmbarrimin në bazë të dokumentit të besueshëm, Faturës nr.19SHV01-001-127 të datës 25.11.2019 në shumë prej 5,400.00€, Faturës nr.241/20 e datës 31.07.2020 në shumë prej 357.50€, Faturës nr.242/20, e datës 19.08.2020 në shumë prej 317.20€, Faturës nr. 243/20, e datës 19.08.2020 në shumë prej 364.00€, Faturës nr.022021001-1, e datës 20.02.2021 në shumë prej 1,600.00€, Faturës nr.013121002-1, e datës 31.01.2021 në shumë prej 1,200.00€, Faturës nr.121421001-1, e datës 14.12.2021 në shumë prej 488.25€, Faturës nr.122221003-1, e datës 22.12.2021 në shumë prej 489.75€, Faturës nr.122921001-1, e datës 29.12.2021 në shumë prej 486.75€, në shumë të përgjithshme prej 10.272,45€, me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 10.272,45€, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e rënies në vonesë deri në pagesën definitive si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës përmbarrimore. Të gjitha këto detyrime duhet të realizohen përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit të hapura në bankat komerciale dhe bartjen e tyre në llogarinë bankare apo përmes përmbarrimit dhe sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen të bëhet inkasimi i borxhit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarrimit, brenda afatit ligjor debitori ka ushtruar prapësim dhe ankesë për parregullsi, duke kundërshtuar kështu në tërësi urdhrin përmbarrimor me arsyetimin se borxhi i paraqitur në fatura nuk është real, kjo për faktin se ka dëshmi të cilat i ka dorëzuar në gjykatë se ka bërë pagesa përmes bankës si dhe të tjera i ka paguar në para të gatshme. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj në tërësi si të bazuar dhe të prish në tërësi urdhrin përmbarrimorë.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Gjykata shfuqizoi Urdhrin Përmbartimor P.nr.203/23 të datës 22.07.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Zija Bala, lidhur me faturën nr.19SHV01-001-127 të datës 25.11.2019 në shumë prej 5,400.00€, për shkak të përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit.

Kjo pasi që sipas vlerësimit të gjykatës, përmes transaksionit bankar të deponuar si provë nga debitori vërtetohet se pagesa në shumë prej 5,400.00€, në emër të faturës nr.19SHV01-001-127 të datës 25.11.2019 është bërë nga ana e debitorit për kreditorin e përmbartimit.

Neni 29, paragrafi 1 i LPP-së, përcakton se: *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Tutje, gjykata la në fuqi Urdhrin Përmbartimor P.nr.203/23, sa i përket Faturës nr.241/20 e datës 31.07.2020 në shumë prej 357.50€, Faturës nr.242/20, e datës 19.08.2020 në shumë prej 317.20€, Faturës nr. 243/20, e datës 19.08.2020 në shumë prej 364.00€, Faturës nr.022021001-1, e datës 20.02.2021 në shumë prej 1,600.00€, Faturës nr.013121002-1, e datës 31.01.2021 në shumë prej 1,200.00€, Faturës nr.121421001-1, e datës 14.12.2021 në shumë prej 488.25€, Faturës nr.122221003-1, e datës 22.12.2021 në shumë prej 489.75€, Faturës nr.122921001-1, e datës 29.12.2021 në shumë prej 486.75€, në shumë të përgjithshme prej 4,872,45€, pasi gjeti se të njëjtat përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së.

Sipas vlerësimit të gjykatës, në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është

detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Për më tepër, gjykata gjen se faturat mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor është lëshuar me rregull nga ana e kreditorit.

Po ashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal.

Gjykata duke iu referuar dispozitave të nenit 79 të LPP-së ku përcaktohet se *“Pala ose pjesëmarrësi tjetër në procedurë mund të parashtrojë një ankesë në Gjykatë, lidhur me parregullsitë që janë kryer nga organi përmbarues gjatë kryerjes së procedurës së përmbarimit. Kjo kërkesë i bëhet Gjykatës me një parashtrësë me shkrim në afat prej shtatë (7) ditësh nda dita e ndodhjes së parregullsisë së pretenduar”*, refuzoi në tërësi si të pabazuar ankesën e debitorit për parregullsi, pasi që gjeti se e njëjta është e pabazuar dhe kryesisht përmban pretendime që ndërliidhen me prapësim.

Andaj, në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1906/23, datë 21.06.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.